


REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



## ***KONTRATË FURNIZIMI***

**KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**“ XHENI GROUP “ SH.P.K. nga Gjilani** (në vazhdim “Operatori Ekonomik”), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Furnizim me dyer automatike për garazhden në objektin e Zjarrfikësve**

Me numër Identifikues **651-19-1451-1-3-6**

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim me dyer automatike për garazhden në objektin e Zjarrfikësve – sipas përshkrimit në aneksin 1 të DT - specifikat teknike të detyrueshme.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **me datën e nënshkrimit nga të palët dhe përfundon me një afat prej 60 ditëve pune.**

1.3 Afati kohor i performances **nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i **dërgimit të furnizimeve** do të jetë: **Në objektin e zjarrfikësve.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP<sup>1</sup>** (Detyra e Dërguar e Paguar).

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **2.200,00 €; Dy mijë e dyqindë Euro. zero zero cent.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*.

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin ***t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat*** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së ***furnizimeve*** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.**





#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe*, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

##### Për Operatorin Ekonomik

##### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Izet Kurteshi	Emri:	Xhelal Ajeti
Pozita:	U.D. Zyrtarë përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.05.2019	Data:	17.05.2019
Vula:		Vula:	

Nr. i Artikullit	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi njesi DDP <sup>1</sup> -€	Cmimi total €
1.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Madhesia e dverve eshte 6000 eshte gjersia x 3.5 m lartesia e dyert duhet te jene automatike dhe manuel ( ku shpejtesia e hapjes te jete e shpejt</li> <li>- Materiali i dverve te jete Panelli 4.2 cm ( trashesia e dverve)</li> <li>- Dyer te hapen vertikalisht</li> <li>- Motori i dverve te jete industrial ( ti pershater madhesise se dverve)</li> <li>- Perforcimi, mbajtja konstruksioni i dverve ti pershater madhesise se dverve</li> <li>- Ne dyer te vendoset edhe dere e vogel me dimenzione 0.90 m X 2.00m</li> <li>- Ne dyer te vendosen edhe 3 driare me dimenzione 60 cm X 30 cm</li> </ul>	cope	1	2200	2200
<b>Totali i Pergjithshem:</b>					2200



<sup>1</sup> Detyrimi Doretimi eshte F.aguar - Incolorms 2010 Oda Ekonomike Nderkombetare.